

Tiranë, më 25.7.2024

### Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me shumicë votash vendosi:

- 1. Ndryshimin e vendimit nr. 632, datë 8.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia.*
- 2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia, për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit 1-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- 3. Ky vendim ka efekt të menjëhershëm.*

*U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.7.2024.*

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.